



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMELORE PRIZREN - DEGA E GJYKATËS DRAGASH

Numri i lëndës: 2018:069155

Datë: 05.02.2019

Numri i dokumentit: 00219067

P.nr. 158/18

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE PRIZREN - DEGA E GJYKATËS DRAGASH
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM DIVIZIONI PENAL Sipas gjyqtarit Bekri Vehapi, me pjesëmarrjen e procesmbajtëses Xharije Skenderi në lëndën penale kundër të pandehurit B. K. Nga fsh. Rr., Komuna Dragash, për shkak të veprës penale sulm nga Neni 187 paragrafi 1. të Kodit Penal të Republikës së Kosovës Nr.04/L-082 (KPRK), duke vendosur sipas aktakuzës së Prokuroria Themelore Prizren - Departamenti i përgjithshëm nr. PP/II.nr.2516-9/18 , të datës 03.12.2018 në seancën publike të shqyrtimit gjyqësor të mbajtur me datë 24.01.2019, në praninë e Prokurorit të Shtetit Atnor Skoro të pandehurit B. K., të dëmtuarit B. B. , më datë mori dhe publikisht shpalli, këtë:

A K T G J Y K I M

I Akuzuari:

B. K., i lindur me dt... në fsh. Rr., Komuna e Dragashit, nga i ati L., e ëma S. lindur K., ka të kryer shkollën Mesme, i pa punë, i martuar i gjendjes së dobët ekonomike familjare, e përkatësis Shqiptar, shtetas i R. së Kosovës, me vendbanim të përhershëm në Vendlindje.

Ë S H T Ë F A J T O R

Se me dt. 15.06.2018, rreth orës 17,00 min. në fshatin K., komuna e Dragashit, në rrugë afër shtëpis së mikut të tijë e përdor forcën ndaj të dëmtuarit- ishë dhëndrit të tijë B. B. nga fshati Zh., Komuna e Prizrenit, në atë mënyrë që pas një mosmarrveshje që kishin në mesë tyre, për çështje familjare, ditën kritike derisa i dëmtuari ishte duke kaluar me veturën e tijë në rrugën kryesore të fshatit K., takohet ball për ball me veturën e të pandehurit, i cili e ndalon veturën e tijë, del nga vetura dhe nisjet në drejtim të veturës së të dëmtuarit, ku fillimisht e ofendon me fjalë fyse, pastaj e hapë derën e veturës së të dëmtuarit, e nxjerrë nga vetura dhe e

sulmon fizikisht duke e goditur me grushta në pjesë të ndryshme të trupit, por nuk i shkakton lëndime të dukshme trupore.

Këso dore ka kryer veprën penale të sulmit nga neni 187 paragrafi 1. të KPK-së.

Andaj gjykata në bazë të dispozitave të lartëshenuara dhe neneve 2,4,6,7,41,42,43,49,50,51 dhe 52. të KPK-së dhe nenin 365. të KPPK-së i shqipton,

DENIM ME GJOBË

Në shumën prej 100,00 Euro (njëqindeuro), të cilën gjobë i pandehuri është i obliguar që ta paguaj në fatë prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmerisë së këtij aktgjykimi në llogarin bankate përmes kësaj gjykate, Në të kundërtën do të bëhet ekzekutimi i dhunëshëm i gjobës, përmes llogaris bankare, ose do të bëhet zavendsimi i gjobës me denim me burg në kohzgjatje prej 5 ditëve, duke e llogarit 20,00 euro (njëzeteuro) për një ditë burgu.

I pandehuri **OBLIGOHET** që të paguaj shpenzimet e procedurës penale aqë sa i llogarit gjykata dhe atë: shumën prej 20,00 €, (njëzeteuro), në emër të paushallit gjyëqsor, si dhe 30,00 Euro (tridhjetetro) në emër të shpenzimit të kompenzimit të viktimave të krimit, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmerisë së këtij Aktgjykimi.

I dëmtuari për realizimin e kërkesës pronsoro-juridike udhëzohet në kontest të rregullt civilo-juridik.

A r s y e t i m

Prokurorija Themelore në Prizren, pranë kësaj gjykate ka paraqitur Aktakuzën PP.nr. 2516-9/18 të dt. 03.12.2018, kundër të pandehurit B. K. nga fshati Rr., Komuna e Dragashit, për veprën penale të Sulmit nga nenin 187. par. 1. të KPK-së, sipas të cilës Prokurori i shtetit Atnor Skoro në fjalën e fundit kërkon që i njejtë të shpallet fajtor dhe të denohet sipas Ligjit.

I pandehuri B. K., në shqyrtimin fillestar, të dt. 24.01.2019, në mbrojtjen e tij deklaroi: se e pranon fajsinë për veprën penale të sulmit nga neni 187, par 1. të KPK-së, ka deklaruar se pendohet për veprën penale të kryer, se nuk do ta përsërisë veprën, se veprimin e ka kryer rastësisht. Nga këto rrethana kërkon nga gjykata që të i mundësohet zbutja e denimit, gjegjësisht ti shqiptohet një denim më të butë, ngase ai dhe familja e tij jetojnë në një gjendje të vështir ekonomike.

Me pranimin e fajsisë nga ana e të pandehurit, si dhe provave tjera si në shkresat e kësaj lënde, kallximit penal me nr. 2018-GD-78, deklarates së të pandehurit B. K. si në shkresat e lëndës të policisë, pa dyshim është vërtetuar Se me dt. 15.06.2018, rreth orës 17,00 min. në fshatin K., komuna e Dragashit, në rrugë afër shtepisë së mikut të tijë e përdor forcën ndaj të dëmtuarit- ish dhëndrit të tijë B. B. nga fshati Zh., Komuna e Prizrenit, në atë mënyrë që pas një mosmarrveshjeje që kishin në mesë tyre, për çështje familjare, ditën kritike derisa i dëmtuari ishte duke kaluar me veturën e tijë në rrugën kryesore të fshatit K., takohet ball për ball me veturën e të pandehurit, i cili e ndalon veturën e tijë, del nga vetura dhe nisat në drejtim të veturës së të dëmtuarit, ku fillimisht e ofendon me fjalë fyse, pastaj e hapë derën e veturës së të dëmtuarit, e nxjerrë nga vetura dhe e sulmon fizikisht duke e goditur me grushta në pjesë të ndryshme të trupit, por nuk i shkakton lëndime të dukshme trupore

Këso dore ka kryer veprën penale të sulmit nga neni 187 paragrafi 1. të KPK-së.

Gjykata këtë gjendje faktike e ka vërtetuar edhe nga pranimit i vullnetshëm i fajsisë nga i pandehuri dhe atë në shqyrtimin fillestar ku e pranon veprën penale e cila sipas Aktakuzës së Prokurorisë i vëhet në barrë. Gjykata nuk ka gjetur ndonjë provë të pa pranueshme dhe gjithashtu është vërtetuar se i pandehuri e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit. Nga kjo gjykata ka ardhur në përfundim se në veprimet e të pandehurit janë prezente të gjitha elementet që e formojn veprën penale të sulmit nga neni 187 Par.1 të KPK-së, për çka i pandehuri është shpallur fajtor dhe është denuar si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

Gjykata me rastin e marrjes së vendimit mbi shqiptimin të denimit me gjobë, ndaj të pandehurit ka pasur parasysh të gjitha rregullat e përgjithshme për matjen e denimit të parapar nga neni 51, 74 dhe 75 të KPK-së, duke pasur parasysh të gjitha rrethanat në lidhje me veprën dhe kryesit, konsiderohet se është e mjaftueshme për tu arritur qellimi i denimit, dhe se të pandehurit i është bërë me dije se e ka kryer veprën penale të dhunëshme dhe të rrezikshme, si dhe duke pasur parasysh sjelljet e mëparshme të të pandehurit, sjelljet e tij pas kreyerjes së veprës penale, shkallën e përgjegjësisë penale dhe rrethanat tjera në të cilat është kryer vepra penale, si dhe në faktin se i pandehuri premtonte se në të ardhmen nuk do të bie ndesh me dispozitat ligjore, e të gjitha këto me bindje se edhe me këtë denim të kushtzuar do të arrihet efekti i sanksionit penal.

Vendimi për shpenzimet e procedurës penale është marr konform nenit 450 par. 1 dhe 2, të KPPK-së, dhe nenit 39. Të Ligjit për kompenzimin e viktimave të krimit.

Më sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE PRIZREN - DEGA E GJYKATËS DRAGASH
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM , DIVIZIONI PENAL**

2018:069155, 24.01.2019

G j y q t a r i

Bekri Vehapi

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga koha e pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate Themelore.